

**VENDIM**  
**Nr. 368, datë 20.5.2026**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË LIDHJES NË  
RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VETËPRODHUESIT E ENERGJISË SË  
RINOVUESHME DHE TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË TYRE, BAZUAR NË  
METODOLOGJINË E FATURIMIT NETO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 20, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të lidhjes në rrjetin e shpërndarjes për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme dhe të skemës së kompensimit të tyre, bazuar në metodologjinë e faturimit neto, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), Enti Rregullator i Energjisë dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Albana Koçiu**

**RREGULLAT DHE PROCEDURAT E LIDHJES NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR  
VETËPRODHUESIT E ENERGJISË SË RINOVUESHME DHE SKEMA E KOMPENSIMIT  
TË TYRE, BAZUAR NË METODOLOGJINË E FATURIMIT NETO**

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Objekti i këtyre rregullave është përcaktimi i të drejtave dhe i përgjegjësiive të vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, skemës së kompensimit të vetëprodhuesit të energjisë së rinovueshme, bazuar në metodologjinë e faturimit neto, procedurës së trajtimit të aplikimeve, kërkesave teknologjike e teknike, si dhe rregullave për shitjen e tepricës së energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes.

Këto rregulla synojnë të garantojnë:

- a) akses të drejtë, transparent dhe jodiskriminues në rrjetin e shpërndarjes;
- b) promovimin e vetëprodhimit, vetëkonsumimit dhe përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme;
- c) integrimin e vetëprodhuesve në tregun e energjisë elektrike;
- ç) kompensim të drejtë dhe proporcional për energjinë e injektuar në rrjetin e shpërndarjes.

## Neni 2

### Përkufizimet

Termat e përdorur në këto rregulla kanë kuptimin, si më poshtë vijon:

1. **“Furnizues”**, një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
2. **“Periudha e faturimit”** nënkupton muajin ndërmjet dy leximeve të matësit inteligjent në pikën e matjes së miratuar të vetëprodhuesit, në bazë të së cilës gjenerohet fatura për atë periudhë nga furnizuesi.
3. **“Person”**, një person fizik ose juridik.
4. **“Skema e kompensimit bazuar në faturimin neto”** nënkupton mekanizmin e faturimit neto, nëpërmjet të cilit teprica e energjisë elektrike, e injektuar në rrjetin e shpërndarjes, do të blihet nga furnizuesi, me të cilin vetëprodhuesi ka një kontratë furnizimi për energjinë elektrike dhe diferenca pozitive ndërmjet vlerës monetare së përftuar nga energjia e injektuar në rrjet dhe asaj të konsumuar nga rrjeti do të transferohet si kredi monetare në muajin pasardhës të faturimit.
5. **“Skemë mbështetëse”**, çdo instrument, skemë ose mekanizëm i aplikuar, që nxit përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, duke ulur koston e asaj energjie, duke rritur çmimin me të cilin mund të shitet ose duke rritur volumin e kësaj energjie të blerë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në ndihmë për investime, përjashtime ose reduktime tatimore, rimbursime tatimore ose skema të mbështetjes direkte të çmimeve.
6. **“Kredite monetare”**, diferenca pozitive ndërmjet vlerës monetare të përftuar nga energjia e injektuar në rrjet dhe vlerës monetare të energjisë së konsumuar nga rrjeti, e cila transferohet si kredi monetare në muajin pasardhës të faturimit.

## KAPITULLI II

### KRITERET E PRANUESHMËRISË DHE PROCEDURA E APLIKIMIT

## Neni 3

### Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë

1. Çdo konsumator familjar ose jofamiljar, lidhur në rrjetin e shpërndarjes, ka të drejtë të bëhet vetëprodhues i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Vetëprodhuesi i energjisë nga burimet e rinovueshme ka të drejtë:
  - a) të gjenerojë energji elektrike për përdorim vetjak;
  - b) të konsumojë, të ruajë dhe të menaxhojë energjinë e prodhuar;
  - c) të shesë prodhimin e tepërt të energjisë elektrike të rinovueshme, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me furnizues të energjisë elektrike dhe marrëveshje të tregtisë me homologët, sipas parimit të barazisë dhe proporcionalitetit.
3. Vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme të vendosur në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë blloqet me shumë apartamente, kanë të drejtë të angazhohen bashkërisht si vetëprodhues të energjisë së rinovueshme dhe atyre u lejohej të organizojnë ndarjen e energjisë së rinovueshme, që prodhohet në ndërtesën e tyre, duke respektuar tarifat e rrjetit dhe tarifa të tjera përkatëse, taksat e tatimet e aplikueshme për çdo vetëprodhues të energjisë së rinovueshme.

#### Neni 4

### **Kapaciteti maksimal i instaluar për vetëprodhuesit**

1. Kapaciteti maksimal i lejuar për t'u instaluar nga vetëprodhuesit e burimeve të rinovueshme të energjisë është 500 kw.
2. Kapaciteti maksimal i instaluar për vetëprodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme nuk duhet të kalojë kapacitetin e instaluar për shpërndarje, të miratuar nga OSSH sh.a.-ja.
3. Kapaciteti maksimal i instaluar do të përcaktohet në bazë të konsumit mesatar vjetor të dy viteve të fundit ose, në rastet kur këto të dhëna nuk disponohen, kjo llogaritje do të bëhet nga një auditues i certifikuar i energjisë, përmes një raporti të auditimit energjetik.
4. Prodhimi i parashikuar vjetor i energjisë elektrike nga impianti për vetëprodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme nuk duhet të jetë më i lartë se konsumi mesatar vjetor, i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, dhe, kur ndodhet në këto raste, do të aplikohet parashikimi sipas pikës 1, të nenit 8, të këtyre rregullave.
5. Vetëprodhuesi i energjisë elektrike ka të drejtë të aplikojë për rritje të kapacitetit të instaluar në rast të rritjes së konsumit vjetor të energjisë elektrike, në përputhje me procedurat dhe kushtet teknike të përcaktuara nga OSSH sh.a.-ja, por jo më tepër se kapaciteti maksimal i lejuar sipas pikës 1, të këtij neni.

#### Neni 5

### **Procedura e aplikimit për vetëprodhuesit e lidhur në rrjetin e shpërndarjes**

1. Aplikimi për lidhjen e një impianti për vetëprodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme me rrjetin e shpërndarjes bëhet pranë OSSH sh.a.-së, në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, të miratuar nga ERE.
2. Brenda 6 muajve nga miratimi i këtyre rregullave, OSSH sh.a.-ja do të krijojë portalin *online* të aplikimeve për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Deri në krijimin e portalit *online*, aplikimi i vetëprodhuesve do të kryhet sipas formës së përcaktuar në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.
3. OSSH sh.a.-ja trajton/shqyrton aplikimin, në përputhje me afatet e përcaktuara në rregulloren e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes dhe njofton aplikuesin, lidhur me miratimin ose refuzimin e aplikimit të lidhjes së re të impiantit për vetëprodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Në rastet kur aplikimi nuk është i plotë dhe mungon ndonjë nga dokumentet dhe/ose informacionet e parashikuara në këtë rregullore, OSSH sh.a.-ja, brenda 10 ditëve punë nga dita e aplikimit, njofton aplikuesin për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, nëpërmjet formës së përzgjedhur të komunikimit nga ky i fundit.
4. Vetëprodhuesi i energjisë elektrike është i detyruar të instalojë me shpenzimet e veta matësin inteligjent me dy drejtime, sipas kërkesave teknike të përcaktuara nga OSSH sh.a.-ja, në përputhje me Kodin e Matjes. Matësi inteligjent duhet të masë energjinë elektrike, që vetëprodhuesi merr nga rrjeti i OSSH sh.a.-së dhe energjinë elektrike, që vetëprodhuesi injekton në rrjetin e OSSH sh.a.-së. Për të njohur konsumin total të energjisë elektrike të vetëprodhuesit, pas inverterit kryesor ose pas daljes së prodhimit kryesor, vendoset një matës me një drejtim për të matur prodhimin e impiantit, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSSH sh.a.-ja, në përputhje me Kodin e Matjes.

5. OSSH sh.a.-ja refuzon aplikimin në rastet kur standardet e projektit dhe lidhjes së tij me rrjetin e shpërndarjes nuk janë në përputhje me Kodin e Shpërndarjes dhe standardet teknike të operuesit të rrjetit, nuk i garantojnë aplikuesve frekuencën në kufirin normal të funksionimit, luhatjet e lejuara të tensionit dhe parametra të tjerë teknikë, sipas legjislacionit në fuqi, në pikën ku kërkohet lidhja e re. Në çdo rast, OSSH sh.a.-ja do të njoftojë aplikuesin me shkrim për arsyet e refuzimit.

6. Çdo aplikues gëzon të drejtën e ankimit tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe ERE, në rast të refuzimit të aplikimit. Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesës së paraqitur do të bëhet sipas parashikimeve të ligjit në fuqi “Për sektorin e energjisë elektrike”.

7. Çdo aplikues ka të drejtë të aplikojë përsëri në rast refuzimi të aplikimit. Në rast refuzimi për arsye teknike, aplikuesi mund t’i propozojë OSSH sh.a.-së përmirësimin e cilësisë së rrjetit, në pikën ku kërkohet të lidhet me shpenzimet e tij. Në këtë rast, OSSH sh.a.-ja do të marrë në shqyrtim propozimin e aplikuesit, sipas legjislacionit në fuqi.

8. OSSH sh.a.-ja, në përputhje me zhvillimet teknologjike të kohës, do të vendosë standardet dhe kushtet teknike të zbatueshme për sigurinë, në përputhje me gjendjen e rrjetit të shpërndarjes, por, në çdo rast, duke mos kufizuar nëpërmjet këtyre kushteve, të drejtën e dhënë nga ligji nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë”, për aksesin në rrjet dhe të drejtën e injektimit të energjisë së tepërt në rrjetin e shpërndarjes.

9. Mbajtësi i miratimit për lidhje në rrjetin e shpërndarjes, si vetëprodhues i energjisë elektrike, duhet të ndërtojë dhe të instalojë impiantin për vetëprodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, brenda 9 (nëntë) muajve nga data e miratimit të aplikimit dhe të njoftojë OSSH sh.a.-në në momentin që ka plotësuar kushtet për energjizim. Në rast të mosrealizimit të impiantit, brenda këtij afati, aplikuesit i lind e drejta të kërkojë shtyrjen e afatit, vetëm një herë, jo më shumë se gjysma e afatit fillestar. Në rast mosrealizimi, aplikimi anulohet dhe duhet të përsëritet nga e para.

10. Përpara vënies në punë të impiantit për vetëprodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, vetëprodhuesi duhet të njoftojë me shkrim OSSH sh.a.-në, duke paraqitur dokumentacionin, si vijon:

a) manualët dhe fletët teknike të produkteve të impiantit të vetëprodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, siç janë panelet, inverterat, bateritë, matësit, materialet elektrike dhe çdo pajisje tjetër të instaluar;

b) të dhënat e nevojshme për krijimin e regjistrit elektronik, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 10, të këtyre rregullave;

c) të dhëna të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të qartë nga operatori i rrjetit në momentin e miratimit të pikës së lidhjes ose sipas Kodit të Rrjetit, përfshirë edhe për qëllim të marrjes në dorëzim të pikës së lidhjes.

11. OSSH sh.a.-ja do të shkëpusë lidhjen me rrjetin e impiantit të vetëprodhimit të energjisë së rinovueshme, në rast se konstaton se vetëprodhuesi i energjisë elektrike ka instaluar një impiant në harkun kohor të tre muajve, kur konfirmohet se impianti është instaluar dhe/ose funksionon ndryshe nga projekti i miratuar. Në të gjitha rastet, OSSH sh.a.-ja njofton me shkrim dhe ndërhyr për ndërprerjen e aksesit në rrjet, nëse personi fizik ose juridik nuk ka kryer rregullimet e propozuara nga OSSH sh.a.-ja, brenda 30 ditëve nga njoftimi.

12. Brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, OSSH sh.a.-ja i propozon ERE-s për miratim ndryshimet e nevojshme në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, me qëllim përcaktimin e procedurave dhe afateve të lehtësuara për lidhjen në rrjet të vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

13. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, OSSH sh.a.-ja i propozon ERE-s ndryshimet në Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes, të cilat mund të preken nga këto rregulla.

### KAPITULLI III SKEMA E KOMPENSIMIT BAZUAR NË FATURIMIN NETO

#### Neni 6

#### **Kushtet e përgjithshme të skemës së kompensimit bazuar në faturimin neto**

1. Vetëprodhuesi, i cili është pjesë e skemës së kompensimit, bazuar në faturimin neto, ka të drejtë të nënshkruajë një marrëveshje blerjeje energjie me furnizuesin, me të cilin ka një kontratë furnizimi për energjinë elektrike.

2. Teprica e energjisë elektrike e injektuar në rrjetin e shpërndarjes do të blihet nga furnizuesi, me të cilin vetëprodhuesi ka një kontratë furnizimi për energjinë elektrike dhe diferenca pozitive ndërmjet vlerës monetare të përftuar nga energjia e injektuar në rrjet dhe asaj të konsumuar nga rrjeti do të transferohet si kredi monetare në muajin pasardhës të faturimit.

3. Marrëveshja e blerjes së energjisë elektrike për skemën mbështetëse të faturimit neto do të ketë një kohëzgjatje jo më të shkurtër se 1-vjeçare, me të drejtë përtëritjeje.

4. Çdo konsumator, i cili furnizohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a./ Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ka të drejtë të përfitojë nga skema e kompensimit, bazuar në faturimin neto, në përputhje me këto rregulla.

5. Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a./Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i detyruar që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, të paraqesë në ERE për miratim modelin e marrëveshjes tip, ndërmjet furnizuesit dhe vetëprodhuesve, që përfitojnë nga skema mbështetëse e faturimit neto. Enti Rregullator i Energjisë miraton modelin tip të marrëveshjes dhe e publikon atë në faqen zyrtare të saj.

6. Faturimi neto nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a./Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bëhet në baza mujore për secilin vetëprodhues, për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik dhe për impiantet vetëprodhuese të instaluar gjatë një viti kalendarik nga dita e operimit deri më 31 dhjetor të vitit përkatës.

#### Neni 7

#### **Çmimi i energjisë elektrike i gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme**

1. Çmimi i energjisë elektrike i gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme do të përcaktohet bazuar në metodologjinë e faturimit neto.

2. Çmimi i energjisë elektrike i gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme duhet të sigurojë një kompensim të drejtë, që pasqyron vlerën e tregut të energjisë së furnizuar në rrjet, dhe do të shmangë ndërsuvencionet ose diskriminimin e padrejtë ndërmjet vetëprodhuesit të energjisë së rinovueshme dhe konsumatorëve të tjerë.

3. Për vetëprodhuesit e furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a./ Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, çmimi i blerjes së energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes për të gjithë vitin kalendarik do të përllogaritet bazuar në çmimin mesatar të blerjes së tregut të ditës në avancë në *ALPEX*, të vitit të mëparshëm, duke mbajtur në konsideratë kostot e tarifës mesatare të rrjetit të shpërndarjes, atë të transmetimit dhe kostot e balancimit të sistemit, por në çdo rast, çmimi nuk do

të jetë më i ulët se 80% e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët familjarë, të miratuar nga ERE, dhe jo më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE i blerjes së energjisë elektrike të injektuar në rrjetin e shpërndarjes nga prodhuesit e energjisë së rinovueshme, për vitin 2027.

4. Çmimi sipas pikës 3, të këtij neni, miratohet nga Enti Rregullator i Energjisë, brenda muajit dhjetor, për aplikim në vitin pasardhës.

#### Neni 8

### **Kreditet monetare në lekë të përfituara nga faturimi neto për tepricën e energjisë elektrike për klientët e furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal dhe përdorimi i tyre**

1. Skema e kompensimit, bazuar në faturimin neto, do të pasqyrohet në faturën e energjisë elektrike, duke evidentuar si zëra të veçantë vlerën e energjisë elektrike të konsumuar nga rrjeti i shpërndarjes dhe vlerën e energjisë elektrike të injektuar në rrjetin e shpërndarjes nga vetëprodhuesi, bazuar në çmimet përkatëse të shitjes së energjisë elektrike.

2. Diferenca pozitive ndërmjet vlerës monetare të përftuar nga energjia e injektuar në rrjet dhe asaj të konsumuar nga rrjeti do të transferohet si kredi monetare në muajin pasardhës të faturimit për vetëprodhuesin.

3. Kreditet monetare të përftuara nga skema e kompensimit, bazuar në faturimin neto, të papërdorura ende në fund të vitit kalendarik, do t'i transferohen si gjendje kreditore për vitin pasardhës vetëprodhuesit nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a./ Furnizuesi i Mundësisë së Fundit deri në masën 20% të vlerës së energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit.

4. Kreditet monetare, që tejkalojnë masën e përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, do të zerohen.

5. Në rastet e ndryshimit të furnizuesit, kreditet e akumuluar duhet të njihen nga furnizuesi i ri i subjektit. Transferimi i tyre bëhet në marrëveshje midis furnizuesit dhe të furnizuarit. Furnizuesi vendos në dispozicion informacionin për të furnizuarin, në lidhje me kreditet e akumuluar të periudhës.

#### Neni 9

### **Vetëprodhuesit në tregun e dereguluar të furnizimit të energjisë elektrike**

1. Termat, kushtet dhe çmimi i blerjes së energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes përcaktohen nëpërmjet marrëveshjeve të negociuara, bazuar në kushtet e përgjithshme të marrëveshjes TIP, të miratuar nga ERE, ndërmjet vetëprodhuesve dhe furnizuesve në tregun e lirë.

Në çdo rast dhe për sa është e mundshme, palët mund të zbatojnë edhe dispozitat e këtyre rregullave.

2. Termat dhe kushtet e përgjithshme të marrëveshjes tip për blerjen e energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes për furnizuesit privatë të licencuar dhe vetëprodhuesve, që kanë një kontratë furnizimi në treg të lirë, do të miratohen nga ERE.

#### Neni 10

### **Regjistri elektronik i të dhënave për vetëprodhuesit e energjisë elektrike**

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a., brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, do të krijojë dhe do të administrojë një regjister elektronik të mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave në kohë reale, me qëllim krijimin dhe administrimin e një baze të dhënash

për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike nga vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

2. Regjistri elektronik i të dhënave do të përfshijë:

2.1 të dhënat e vetëprodhuesit (emër, mbiemër, adresë, NUIS (nëse ka), tel./cel.);

2.2 tipin e burimit gjenerues të energjisë;

2.3 kapacitetin e instaluar në kw;

2.4 numrin e njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapacitetin e tyre në kw;

2.5 jetëgjatësinë e pritshme të burimit gjenerues të energjisë;

2.6 vendndodhjen e impiantit të vetëprodhimit;

2.7 datën e vënies në punë të impiantit të vetëprodhimit;

2.8 kapacitetin e miratuar të lidhjes;

2.9 të dhënat për orë të injektimit në rrjet të energjisë elektrike nga impianti i vetëprodhimit;

2.10 standardet teknike të pajisjeve të burimit gjenerues të energjisë;

2.11 nivelin e tensionit në dalje të gjeneratorit;

2.12 prodhimin vjetor të energjisë elektrike në kwh.

3. OSSH sh.a,-ja, mbi bazën e këtyre të dhënave, do të hartojë brenda 31 janarit të çdo viti një raport të detajuar të vitit paraardhës, lidhur me numrin e aplikimeve, miratimeve, kapacitetin e tyre në mw, vendndodhjen, prodhimin vjetor, ku përfshihen gjenerimi, konsumi vetjak dhe teprica e injektuar në rrjet, i cili do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, duke garantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

## KAPITULLI IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 11

#### **Dispozita kalimtare**

1. Vetëprodhuesit aktualë, pjesë të skemës mbështetëse të matjes neto, do të kalojnë automatikisht në skemën mbështetëse të faturimit neto, me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes nga ERE, sipas pikës 1, të nenit 7, të këtyre rregullave. Tepricat e krijuara nga skema e matjes neto do të llogariten sipas skemës së re të faturimit neto.

2. Deri në miratimin e çmimit të blerjes së energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes nga ERE, sipas pikës 1, të nenit 7, të këtyre rregullave, do të vijojë zbatimi i skemës mbështetëse të matjes neto.

### Neni 12

#### **Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave**

Këto rregulla janë objekt rishikimi ose ndryshimi, të paktën çdo 5 vjet, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë.